

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.01.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.01.2017, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 15, të datës 11.01.2017, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (a, c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a, c), nenin 27, shkronja (c dhe ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 376,200.00€, nga ‘Kodi i participimit, subvencioneve dhe transfereve’, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2017

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 376,200.00€, nga ‘Kodi i participimit, subvencioneve dhe transfereve’ dhe participimi i fermerëve, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga buxheti i komunës dhe participimi i fermerëve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 14,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e serrave’;
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 14,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e motokultivatorëve’;
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 8,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 1,600.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e spërkatëseve për traktorë’;
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 600.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut artificial’;
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 3,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e Laktofrizave’;
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit ‘Blerja e Folive’;

- 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 3,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e pulave';
- 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 14,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e fidaneve';
- 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 1,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e makinave mjelëse';
- 1.10 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare, në shumë prej 1,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e pompave spërkatëse të krahut';
- 1.11 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 3,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e përzierseve të mullirit';
- 1.12 Mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€ nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 6,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e gjedhave qumështore';
- 1.13 Mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 6,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e mekanizmit bujqësorë';
- 1.14 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës me destinim për realizimin e projektit 'Blerja e plehut artificial';
- 1.15 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 2,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e pajisjeve për bletari';
- 1.16 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës dhe mjetet financiare në shumë prej 1,000.00€ ose 20% nga bashkëfinancimi i fermerëve destinohen për realizimin e projektit 'Blerja e inkubatorëve'.
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë, sipas pikës një (1) të vendimit, nënpikave 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.7, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.13, 1.15 dhe 1.16, participojnë fermerët e komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2017 me mjete financiare në shumë të përgjithshme prej 56,200.00€.
3. Kryerja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 320,000.00€ nga buxheti i komunës, ku hyn edhe mbetja nga participimi i qytetarëve në bujqësi për vitin 2016, në shumë prej 59,020.00€, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 31.01.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.01.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 06, të datës 16.01.2017, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 62, të datës 16.05.2013 miraton:

**PLANIN VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS, KOMITETIT PËR
POLITIKË E FINANCA DHE KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2017**

1. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete përfshin punën dhe aktivitetet e parapara për vitin 2017.
2. Realizueshmëria e Planit Vjetor të Punës për vitin 2017 është:
 - 2.1 Në muajin Janar 2017, në javën e katërt, janë mbajtur mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës dhe janë shqyrtuar:
 - 2.1.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.1.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.1.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale, të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.1.4 Raporti i Punës për Funksionimin e Kuvendit të Komunës në vitin 2016;
 - 2.1.5 Plani i Punës së Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete për vitin 2017;
 - 2.1.6 Propozim për themelimin dhe caktimin e anëtarëve të Komiteteve tjera;
 - 2.1.7 Të ndryshme.
 - 2.2 Në muajin Shkurt 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.2.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorumit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.2.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;

- 2.2.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
- 2.2.4 Shqyrtimi i propozimit për bartjen dhe shpërndarjen e të hyrave vetjake të vitit 2016, në vitin 2017;
- 2.2.5 Të ndryshme.
- 2.3 Në muajin Mars 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.3.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.3.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.3.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3.4 Raporti përfundimtar Vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2016;
 - 2.3.5 Shqyrtimi i Raportit përfundimtar vjetor financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2016;
 - 2.3.6 Të ndryshme.
- 2.4 Në muajin Prill 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.4.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.4.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.4.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.4.4 Shqyrtimi i Raportit financiar për ekzekutimin e buxhetit të planifikuar për periudhën Janar/Mars 2017;
 - 2.4.5 Të ndryshme.
- 2.5 Në muajin Maj 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.5.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.5.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.5.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.5.4 Shqyrtimi dhe miratimi i 'Planit dinamik për organizimin e Dëgjimeve Publike për buxhetin e vitit 2018';
 - 2.5.5 Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2017;
 - 2.5.6 Shqyrtimi i propozimeve për shpalljen e 'Qytetar nderi', për vitin 2017;

- 2.5.7 Raporti i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
- 2.5.8 Informatë e Drejtorisë së Arsimit për rrjedhën e vitit shkollor 2016/2017 dhe përgatitjet e nxënësve për testet e semimaturës dhe maturës shtetërore;
- 2.5.9 Të ndryshme.
- 2.6 Në muajin Qershor 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.6.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.6.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.6.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.6.4 Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2018-2020;
 - 2.6.5 Të ndryshme.
- 2.7 Në muajin Korrik 2017, në javën e tretë, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.7.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.7.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.7.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.7.4 Raportimi i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës për periudhën gjashtëmujore;
 - 2.7.5 Shqyrtimi i Raportit Financiar për ekzekutimin e buxhetit të planifikuar për periudhën Prill/Qershor 2017;
 - 2.7.6 Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2016;
 - 2.7.7 Të ndryshme.
- 2.8 Në muajin Gusht 2017, në javën e katërt, mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
 - 2.8.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuorunit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.8.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.8.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.8.4 Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2017/2018;
 - 2.8.5 Të ndryshme.

- 2.9 Në muajin Shtator 2017, në javën e tretë mbahen mbledhjet e: Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe në javën e katërt mbledhja e Kuvendit të Komunës, shqyrtohen:
- 2.9.1 Hapja e mbledhjes, verifikimi i kuoromit, arsyetimi i mungesave dhe aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - 2.9.2 Pyetje dhe përgjigje parlamentare;
 - 2.9.3 Shqyrtimi i propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve, planeve dhe dokumenteve strategjike komunale të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.9.4 Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të Komunës për vitin 2018;
 - 2.9.5 Të ndryshme.
3. Në muajin Tetor/Dhjetor 2017, sipas kalendarit zgjedhor fillon procesi i Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017, për mandatin zgjedhor të Kuvendit të Komunës 2017-2021, Konfirmimi i mandateve, inaugurimi dhe procedura e ‘Betimit Solemn’ të anëtarëve të Kuvendit të Komunës për mandatin e ardhshëm katërvjeçar.
4. Për zbatimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2017, kompetent është Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
5. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017 hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.01.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.01.2017, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 07, të datës 06.01.2017, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2012), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d, n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 17, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën pesëvjeçare 2017-2021 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik’.

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të ‘Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën pesëvjeçare 2017-2021’.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e ‘Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën pesëvjeçare 2017-2021’ do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe Shoqërinë Civile, që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, në debatin publik të caktuar për datën: 10.02.2017.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 01.02.2017

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.01.2017, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1371, të datës 13.12.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mbështetur në kërkesën Nr. 1363, të datës 12.12.2016, e parashtruar nga 'CARITAS Kosova', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për vazhdimin e realizimit të projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'CARITAS Kosova' për vitin 2017'

1. Aprovohet propozimi Nr. 1371, i datës 13.12.2016, për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 242,848.76€, për vazhdimin e realizimit të projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'CARITAS Kosova' për vitin 2017'.
2. Shuma e mjeteve financiare nga buxheti i komunës, për vazhdimin e realizimit të projektit sipas pikës një (1) të vendimit, lejohet nga kodet ekonomike të projekteve si vijon:
 - 2.1 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 18162, kodi i projektit Nr. 44714 për mirëmbajtje, pastrim të ambientit, ngritja e përkujdesit social, shëndetësor, shtëpiak, ambulator, administrativ, ekonomik, infrastrukturor, e tjera, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 200,000.00€;
 - 2.2 Nga organizata buxhetore Nr. 612, programi Nr. 17502, kodi i partisipimit bashkëfinancim i projekteve, Nr. 44684, lejohet shuma e mjeteve financiare prej 22,818.76€.
3. Për vazhdimin e realizimit të projektit, sipas pikës një (1) të vendimit, 'CARITAS Kosova', financon me mjete financiare në shumë prej 20,030.00€.
4. Me vazhdimin e realizimit të këtij projekti të punësimit në bashkëfinancim me 'CARITAS Kosova' për vitin 2017, rritet përqindja e numrit të punësuarëve në favor të

arsimit e shëndetësisë dhe ndihmohen qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës:

- 4.1 Shërbimet sociale edukative dhe shëndetësore për përmirësimin e kushteve të varfërisë për shtresat sociale;
 - 4.2 Vazhdimin e përkrahjes financiare të punësimit të qytetarëve të komunës tonë - punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative;
 - 4.3 Parandalimi i procesit të migrimit ilegal nëpërmjet krijimit të vendeve të punës;
 - 4.4 Përkujdesje sociale dhe shëndetësore për familjet e komuniteteve: rom, ashkalinj dhe egjiptas.
5. Kryerja e procedurave tjera, lidhja e marrëveshjes për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me 'CARITAS Kosova' dhe siguri i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës (2) të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
 6. Për rezultatet e arrituara në punë përmes punësimit me këtë projekt të përbashkët të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe 'CARITAS Kosova', si bashkërealizues në realizimin e projektit të punësimit informohet me shkrim Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
 7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së ARSIMIT, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi

